



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:253615

Datë: 17.07.2024

Numri i dokumentit: 05947772

**AC-I-23-0075**

**Në ankesën e**

**Paditësi/Ankuesi**

**S S** nga Gjakova, i përfaqësuar nga avokati B I, Prishtinë.

**Kundër:**

**E paditura**

**NSH "Emin Duraku"(në likuidim)**, Gjakovë e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit, (AKP)**, Rruga, "Dritan Hoxha" nr.55, Lakrishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj, dhe Ilmi Bajrami gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, të parashtruar kundër Aktgjykimit të Shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-14-2155, të datës 18 janar 2022, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur me 17 korrik2024, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

- 1. Ankesa e paditësit është e bazuar.**
- 2. Ndryshohet Aktgjykimi i Shkallës së parë i DHPGJS-së, C-IV-14-2155, i datës 18 janar 2022 dhe vendimi i Autoritetit të Likuidimit PEJ110-0158, i datës 03 mars 2014.**
- 3. Paditësit i njihet e drejta në kompensim për paga të papaguara ashtu që e paditura AKP, Obligohet që paditësit S S, në emër të**

**kompensimit për paga të papaguara për periudhën 01 janar 2008 deri me 14 nëntor 2008, t'ia paguaj shumën prej 1,665.00 euro, në emër të interesit ligjor prej 10%, të shumës themelore, t'ia paguaj shumën prej 166.50 euro, për shpenzimet e përfaqësimit të avokatit t'ia paguaj shumën prej 208.00 euro, si dhe shpenzimet për taksë gjyqësore 40.00 euro, sipas prioriteteve të kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave në procedurën e likuidimit.**

#### **4. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

#### **Rrethanat faktike dhe procedurale:**

Me 31 mars 2014, në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, paditësi ka është parashtruar ankesa kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit të NSH "Emin Duraku" PEJ110-0158, të datës 03 mars 2014, me të cilin është refuzuar kërkesa për pagat e pa paguara në shumën 1,665.00€, si e pavlefshme për shkak të parashkrimit. Paditësi në parashtresë të ankesës është deklaruar se para shitjes në tender të Ndërmarrjes, paditësit ju ka mbetur borxh për pagat e pa paguara e i cili fakt nuk është si kontestues. Paguesa nuk është bërë për shkak të vështirësive ekonomike të NSH „Emin Duraku “ në Gjakovë dhe punëtorët kanë pritur mundësin që detyrimi të përmbushet. Paditësi ka qenë punëtor në marrëdhënie të rregullt të punës dhe se atij ju është ndërprerë marrëdhënia e punës, që është bërë ndërprerje e parakohshme për shkak të privatizimit dhe i njëjti është dëmtuar .

Ankesës ja ka bashkangjitur si prova: Vendimin e Autoritetit të Likuidimit PEJ 110-0158, me të cilin është refuzuar kërkesa për pagat e pa paguara në shumën 1,665.00 euro. Njoftimin për punëtorët e NSH „ Emin Duraku “ sipas të cilit NSH është vendosur nën Administrimin e AKP-së ,më dt. 09.04.2009. Lista e punëtorëve shërbimi i sigurimit fizik që nuk ju është paguar paga për periudhën janar- nëntor 2008, në të cilën listë gjendet paditësi me nr. rendor 1, një kopje të padis për kthimin në punë dhe kompensimin e të ardhurave personale , dt. 24 gusht 2011, e parashtruar në DHPGJS nga Shoqata sindikale e punëtorëve, listën e punëtorëve në cilësinë e paditësve, ku emri i paditësit gjendet në numrin rendor 7, Kopjen e Librezës së punës, vërtetimin mbi marrëdhënien e punës të lëshuara nga NSH "Emin Duraku" të dt. 29 janar 2013.

Më 26 gusht 2021, AKP-ja përmes përfaqësuesit ka dorëzuar parashtresën në mbrojtje ndaj ankesës kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit për NSH „Emin

Duraku " PEJ 110-00158, me propozim që ankesa të refuzohet dhe të vërtetohet vendimi AL. Në parashtresë është deklaruar se NSH „Emin Duraku“ ka hyrë në procedurë të likuidimit më datë 02 shtator 2013, ndërsa parashtruesi i kërkesës ka ushtruar kërkesë më 25 tetor 2013, që ka kërkuar pagat e pa paguara në s shumën 1,665.00 euro. Autoriteti i likuidimit mori Vendimin PEJ 110-0158, më dt. 07.03.2014, me të cilin ka refuzuar kërkesën sipas nenit 608 i Ligjit për punën e bashkuar parashikon " pagesa e shumës së pagës apo rrogës ose të ndonjë kërkesë tjetër të punëtorëve që rrjedhin nga marrëdhënie e punës parashkruhet për tre vjet " . Përmes kësaj mbrojtje është deklaruar se Autoriteti i Likuidimit ka bërë vlerësimin e saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat e zbatueshme ligjore gjithashtu janë zbatuar saktësisht dhe se kërkesa e paditësit në pretendim të pagave të tija është parashkruar. Mbrojtjes i ka bashkangjitur Vendimin e Autoritetit të Likuidimit PEJ 110-0158 .

Me 18 janar 2022, Shkalla e parë e DHPGJSK-së me aktgjykimin C-IV-14-2155 e ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e paditësit të paraqitur kundër Vendimit të autoritetit të likuidimit, PEJ110-0158, të datë 03 mars 2014. Shkalla e parë ka arsyetuar se nuk është kontestuese fakti se paditësi ishte punëtorë e të paditurës, deri më dt. 07.09.2012, kur ju është mbyllur Libreza e punës. Nuk është kontestuese as fakti se vet e paditura NSH , para se të vendoset nën administrimin e AKP-së, ka hartuar një listë të punëtorëve të sigurimit fizik, të cilëve nuk ju janë paguar paga për periudhën dt. 01.01.2008 deri më dt. 14.11.2008, e në të cilën listë gjendet paditësi me numrin rendor 1. Për të paditurën si kontestuese është se kërkesa e paditësit është parashkruar. Sipas Vendimit të Autoritetit të Likuidimit, PEJ 110-0158, kërkesa e S S për kompensimin e pagave të pa paguara në shumën 1,665.00 €, është refuzuar duke u mbështetur në nenin 36.2.1 të Shtojcës së ligjit 04/L-034, lidhur me nenin 608 të Ligjit për punën e bashkuar. Shkalla e parë ka vlerësuar se e paditura NSH me listën e hartuar për punëtorët të cilave nuk ju është paguar paga për periudhën datë 01 janar 2008 deri më dt. 14 nëntor 2008, vërteton se me këtë listë e paditura e ka pranuar borxhin e punëtorëve për paga të pa paguara dhe me këtë edhe e ka ndërprerë rrjedhjen e parashkrimit, sipas nenit 387 të LMD-së ( RSFJ ) .

Në rastin konkret parashkrimi i ndërprerë, përsëri ka filluar të rrjedhë, nga fillimi prej datës 15 nëntor 2008, gjithnjë sipas nenin 392 të LMD-së ( RSFJ ) , ashtu që

paditësi nuk ka dorëzuar asnjë provë të ketë iniciuar ndonjë procedurë gjyqësore në realizimin e kërkesës për paga të pretenduara në afatin prej tre viteve , pra deri më dt. 15 nëntor 2011, kur edhe ka lindur parashkrimi më datë 16 nëntor 2011, sipas nenin 362 të LMD-së ( RSFJ ) .

Shkalla e parë ka vlerësuar se pas vërtetimit të kësaj gjendje faktike e cila gjendje është konstatuar edhe nga Autoriteti i Likuidimit , kërkesa e paditësit e cila është dorëzuar te Autoriteti i Likuidimit më datë 25 tetor 2013, ajo ishte parashkruar. Po ashtu ka vlerësuar se në rastin konkret, kërkesa e paditësit në pagimin e pagave të pretenduara prej datës 10 janar 2008 deri më datë 14 nëntor 2008, në shumën 1,665.00 €, nuk është e bazuar për shkak të parashkrimit dhe AL drejt ka vendosur në Vendimin PEJ 110-0158, kur ta refuzuar kërkesën dhe ka zbatuar nenin 36.2.1 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034.

Me 09 shkurt 2023, paditësi nëpërmjet përfaqësuesit për mes postës e dërgon në DHPGJS një ankesë kundër Aktgjykimit të shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-14-2155 të datës 18 janar 2022 dhe kërkon nga Kolegji i Apelit të aprovohet ankesa si e bazuar, ose të priset aktgjykimi i ankimuar dhe lënda të kthehet në rigjykim te gjyqtari individual, duke e detyruar të paditurën që në emër të kompensimit të pagave të pa paguara t'i kompensojë paditësit për periudhën 01 janar 2008 deri më 14 nëntor 2008 në vlerë të përgjithshme prej 1,655.00 euro si dhe interesin në pagesa të vonuara 10%. Si dhe te detyrohet e paditura që të bëjë kompensimin e shpenzimeve të përfaqësimit në bazë të tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës për kërkesën ndaj Autoritetit të Likuidimit (AL) në shumën prej 52.00 euro sipas nr. tarifor 16, shqyrtimin e shkresave të lëndës në shumën prej 52.00 euro sipas nr. tarifor 15, pika 1 hartimin e padisë në shumë prej 104.00 euro, sipas nr. tarifor 6, pika 1, për hartimin e ankesës ndaj Aktgjykimit të shkallës së parë në shumën prej 40.00 euro në emër të taksës gjyqësore.

Paditësi në ankesë ka theksuar se ishte në marrëdhënie të rregullt pune të e paditura që nga data 11 dhjetor 1974 më 07 shtator 2012, kur i është mbyllur Librezja e punës, për shkak të likuidimit të ndërmarrjes. Si provë ka bashkangjitur Librezën e Punës. Më 17 nëntor 2008 një pjesë e punëtorëve të Ndërmarrjes Shoqërore E D ishin larguar nga puna përveç menaxhmentit të ndërmarrjes të cilët ishin emëruar nga AKP-ja , në mesin e të cilave ishte edhe paditësi S S. Si provë ka bashkangjitur Listën e punëtorëve të larguar nga puna e datës 17 nëntor 2008

dhe Lista me të ardhurat personale të mbetura borxh nga na e NSH nga data 01 janar 2008 deri më 14 nëntor 2008. Ka shtuar se me 17 nëntor 2008, AKP-ja kishte dërguar një Njoftim me shkrim me të cilën e ka konfirmuar menaxhmeti i NSH "Emin Duraku" ka vazhduar punën dhe të gjithë janë siguruar se nuk do të mohohet asnjë e drejtë nga marrëdhënia e punës. Si provë ka bashkangjitur: Njoftimin e AKP-së të datës 17 nëntor 2008. Me 13 maj 2011, Shoqata Sindikale e pavarur e H.C " Emin Duraku"Sh.A, ka ushtruar padi për kthimin në vendim e punës dhe kompensimin e të ardhurave personale për 33 punëtorët të cilët kanë nënshkruar petitionin, ankuesi është i renditur me numrin rendor 7. Padia është regjistruar në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe sipas regjistrimit të gjykatës ka numrin SCC-11-0146.

Pas fillimit të procedurës së Likuidimit, ankuesi ka parashtruar kërkesë për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën 01 janar 2008 deri më 14 nëntor 2008 në shumë prej 1,165.00 euro. Më datë 07 mars 2014 e paditura ka nxjerrë Vendimin PEJ 110-0158, me anë të cilit ka refuzuar kërkesën ankuesit si të parashkruar. Brenda afatit të paraparë ligjor, ankuesi kishte dorëzuar ankesë kundër Vendimit të lartcekur. Siç shihet nga Libreza e punës, paditësi i është ndërprerë marrëdhënia e punës më datë 07 shtator 2012, ndërsa kërkesa ishte parashtruar në Autoritetin e Likuidimit më datë 25 tetor 2013.

Paditësi tutje në ankesë ka theksuar se shkalla e parë me aktgjykimin C-IV-2155, e ka refuzuar kërkesën e ankuesit me arsyetimin së kërkesa e ankuesit është parashkruar duke u bazuar në nenin 392 të LMD-së (RSFJ) pasi që paditësi nuk ka dorëzuar asnjë provë të ketë iniciuar në ndonjë procedurë gjyqësore në realizimin e kërkesës për paga të pretenduara në afatin prej 3 vite, pra deri më datë 15 nëntor 2011 kur ka filluar parashkrimi me datë 16 nëntor 2011, sipas Nenit 362 të LMD-së.

Nuk është kontestuese fakti se vet e paditura para sete vendoset nën administrimin e AKP-së ka hartuar një listë të punëtorëve para se të vendoset nën administrimin e AKP-së ka hartuar një listë të punëtorëve të sigurimit fizik, të cilëve nuk u janë paguar pagat për periudhën nga data 01 janar 2008 deri më datë 14 nëntor 2008 në të cilën listë gjendet paditësi me numër rendor 1. Vendimi AL-së ishte bazuar në nenin 608 të LPB-së por tani gjyqtari në procedurën e kundërshtimit të vendimit të AL-së ka gjetur një bazë tjetër juridikë konkretisht parashkrimin nga Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) të datës 30 mars 1978, neni 392, e cila nuk përmendej fare në vendimin e AL-së.

Tutje në ankesë ka shtuar se Kërkesa e ankuesit nuk mund të llogaritet parashkruar pasi që Sindikata e punëtorëve të Ndërmarrjes Shoqërore "Emin Duraku" më datë 13 maj 2011, ka dorëzuar në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme padinë për kthim në marrëdhënien e punës dhe kompensimin të ardhurave personale, lënda sipas regjistrimit të gjykatës ka numrin SCC-11-0146. Kjo lëndë është aktive në gjykatë dhe deri më tani nuk ka asnjë vendim në lidhje me kërkesën e paditësve për kthim në marrëdhënien e punës e as për kompensimin e të ardhurave personale. Me parashtrimin e padisë nga ana e sindikatës së punëtorëve serish ka filluar të rrjedh afati, ashtu siç e parasheh Neni 388 i Ligjit mbi marrëdhëniet e Detyrimeve nr.30 mars 1978 i cili parasheh se " Parashkrimi ndërpritet me ngritjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarre kundër debitorit para gjykatës ose organit tjetër kompetent me qëllim përcaktimi, sigurimi ose realizimi të kërkesës.

Me 05 mars 2024, AKP-ja e dorëzon në DHPGJS një parashtrësë dhe i përgjigjet ankesës paditësit. Në këtë parashtrësë AKP-ja e kundërshton ankesën e paditësit si të pabazuar dhe kërkon që të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së si i bazuar në ligj. Tutje AKP-ja ka pohuar se në mbrojtjen në padi ka sqaruar mjaftueshëm lidhur me argumentet e ngritura të ankesës dhe përsëritja e atyre argumenteve do të ishte e pa dobishme për mbarëvajtjen e procedurës. AKP-ja ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pabazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

### **Arsyetimi ligjor**

Ankesa e paditësit është e bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

### **Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit**

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë i DHPGJS-së, nuk është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet ndryshohet dhe të aprovohet kërkesa si e bazuar.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me datë 25 tetor 2013, e ka dorëzuar tek Autoriteti i Likuidimit të NSH "Emin Duraku" Gjakovë, (në likuidim), një kërkesë për kompensim për të papaguara në shume prej 1,665.00 euro, por që ishte refuzuar me arsyetimin se kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Me 18 janar 2022, Shkalla e parë e DHPGJSK-së me aktgjykimin C-IV-14-2155 e ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e paditësit për shkak të parashkrimit të kërkesës dhe ka vërtetuar Vendimin e AL, PEJ110-0158, të datë 03 mars 2014. Shkalla e parë kishte ka vlerësuar se e paditura NSH me listën e hartuar për punëtorët të cilave nuk ju është paguar paga për periudhën datë 01 janar 2008 deri më dt. 14 nëntor 2008, vërtetohej se me këtë listë e paditura e ka pranuar borxhin e punëtorëve për paga të pa paguara dhe me këtë edhe e ka ndërprerë rrjedhjen e parashkrimit, sipas nenit 387 të LMD-së ( RSFJ ) , por që në rastin konkret parashkrimi i ndërprerë, përsëri ka filluar të rrjedhë, nga fillimi prej datës 15 nëntor 2008, gjithnjë sipas nenin 392 të LMD-së ( RSFJ ) ashtu që paditësi nuk ka dorëzuar asnjë provë të ketë iniciuar ndonjë procedurë gjyqësore në realizimin e kërkesës për paga të pretenduara në afatin prej tre viteve , pra deri më dt. 15 nëntor 2011, kur edhe ka lindur parashkrimi më datë 16 nëntor 2011, sipas nenin 362 të LMD-së ( RSFJ ) .

Kundër këtij aktgjykimi paditësi ka parashtruar ankesë dhe tutje pretendon se atij i takon kompensimi për paga të papaguara për periudhën datë 01 janar 2008 deri më dt. 14 nëntor 2008, në shume prej 1,655.00 euro, e cila shume i ishte njohur nga vet NSH-ja dhe se kërkesa e tij nuk është parashkruar.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me ankesën e tij të dorëzuar në Shkallën e parë kishte bashkangjitur Vendimin e Autoritetit të Likuidimit PEJ110-0158, me të cilin është refuzuar kërkesa për pagat e pa paguara në shumën 1,665.00 euro, Njoftimin për punëtorët e NSH " Emin Duraku " sipas të cilit NSH është vendosur nën Administrimin e AKP-së , më dt. 09.04.2009, Listen e punëtorëve shërbimi i sigurimit fizik që nuk ju është paguar paga për periudhën 01 janar 2008- nëntor 2008, në të cilën listë gjendet paditësi me nr. rendor 1, një kopje të padis për kthimin në punë dhe kompensimin e të ardhurave personale , dt. 24 gusht 2011, e

parashtruar në DHPGJS nga Shoqata sindikale e punëtoreve, listën e punëtoreve në cilësinë e paditësve, ku emri i paditësit gjendet në numrin rendor 7, Kopjen e Librezës së punës, vërtetimin mbi marrëdhënien e punës të lëshuara nga NSH "Emin Duraku" të dt. 29 janar 2013.

Kolegji i Apelit vlerëson se nga dëshmitë e bashkangjitura nga paditësi vërehet se nuk është kontestuese se paditësi ishte në marrëdhënie pune në NSH dhe se atij i ishte ndërprerë marrëdhënia e punës me dt. 07.09.2012, kjo vërtetohet nga librezja e punës të cilën paditësi e ka dorëzuar si provë. Po ashtu nuk është kontestuese as fakti se vet e paditura NSH, para se të vendoset nën administrimin e AKP-së, ka hartuar një listë të punëtorëve të sigurimit fizik, të cilëve nuk ju janë paguar paga për periudhën dt. 01.01.2008 deri më dt. 14.11.2008, e në të cilën listë gjendet paditësi me numrin rendor 1.

Çështje kontestuese sipas të paditurës ishte se kërkesa e paditësit është parashkruar e për të cilën Kolegjit të Apelit këtë konstatim e konsideron të gabuar, pasi që e paditura NSH me listën e hartuar për punëtorët të cilave nuk ju është paguar paga për periudhën datë. 01 janar 2008 deri më dt. 14 nëntor 2008, vërteton se me këtë listë e paditura e ka pranuar borxhin e punëtorëve për paga të pa paguara dhe me këtë edhe e ka ndërprerë rrjedhjen e parashkrimit, sipas nenit 387 të LMD-së ( RSFJ ) i cili ishte ligj në fuqi, ndërsa përsëri me padinë për kthimin në punë dhe kompensimin e të ardhurave personale të dt. 24 gusht 2011, e cila ishte parashtruar në DHPGJS nga Shoqata Sindikale e punëtoreve, shihet se paditësi gjendet me nr. rendor 7. Në rastin konkret parashkrimi është ndërprerë me këtë padi të dorëzuar në DHPGJS, andaj arsyet e dhen në aktgjykimin e kundërshtuar se paditësi nuk ka dorëzuar prova me të cilat do dëshmohej se ka iniciuar ndonjë procedurë gjyqësore në realizimin e kërkesës për paga të pretenduara në afatin prej tre viteve, pra deri më dt. 15 nëntor 2011, janë ta gabuara dhe në kundërshtim me provat e bashkangjitura që gjenden në shkresat e lëndës.

Paditësi pretendon se atij i takojnë pagat e kërkuara të papaguara. E paditura përveç thirrjes në parashkrim nuk e ka dëshmuar të kundërtën me prova, përkatësisht nuk ka dëshmuar me asnjë provë se paditësit i ka përmbushur obligimin e saj për pagat e papaguara. Në këtë rast e paditura e ka barrën e



dëshmisë për ta provuara të kundërtën meqë ajo i mban edhe dokumentet e NSH-së dhe ka listë pagesën e pagave për punëtorët e NSH-së.

Kolegji i Apelit vëren se në bazë të dëshmive të ofruar nga paditësi, Shkalla e parë e DHPGJS-së nuk kishte bazë ligjore ta refuzoj ankesën e paditësit, për shkak të parashkrimit ashtu që paditësit i takojnë pagat e paguara në shumë prej 1,655.00 euro.

Kolegji i Apelit ia njeh paditësit shumën prej 166.50 euro, në emër të interesit ligjor prej 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore, bazuar në nenin 37.3 të shtojcës së Ligjit nr. 04 / L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, ndërsa në bazë të nenit 62.2 të LDHP-së, paditësit i njihet e drejta e kompensimit të shpenzimeve të Avokatit në shumë prej 208 euro, si dhe 40.00 euro shpenzimet për taksë gjyqësore, të cilat shuma do të paguhën sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.

Prandaj nga këto arsye, aprovohet ankesa e paditësit si bazuar, dhe ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar i shkallës së parë dhe Vendimi i Autoritetit të Likuidimit.

Nga këto arsye, e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

### **Taksa gjyqësore**

Në pajtim me Udhëzimin Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) nr. 01/2017, ankuesi lirohet nga pagesa e taksës gjyqësore meqë i njëjti është përfutës i Ndihmave Juridike Falas, sipas vendimit A.nr.116/23-07 të lëshuar me dt. 17.03.2023.

Lëshuar nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së 17 korrik 2024

Mr. Sc Sahit Sylejmani , Gjyqtar Kryesues \_\_\_\_\_